



Ky projekt financohet nga
Bashkimi Evropian


ARISE - Iniciativa për zvogëlimin e pabarazive në arsim



Përmbledhje mbi politikat në Kosovë

Gjatë dhjetëvjetëshit të fundit, Kosova ka kaluar nëpër reforma të mëdha në arsim, duke filluar nga decentralizimi i sistemit arsimor deri te zhvillimi i kornizës kurrikulare të bazuar në kompetenca, zhvillimi i mekanizmave për sigurimin e cilësisë, zhvillimi profesional i mësimeve dhe sistemi i licencimit, zgjerimi i përdorimit të TIK etj. Sido që të jetë, përkundër këtyre reformave, cilësia e arsimit mbetet e dobët. Kjo u dëshmuar edhe me rezultatet e PISA 2018, të cilat treguan se nxënësi 15 vjeçar i Kosovës shënoi ndër rezultatet më të dobëta në të gjitha disiplinat e testimit.

GRAFIKU 1. REZULTATET E PISA 2018 PËR KOSOVËN



Megjithatë, në aspektin e ndikimit të statusit socio-ekonomik (SSE) në arritjet e nxënësve, rezultatet e PISA 2018 treguan se hendeku ndërmjet grupeve socio-ekonomike të ulëta dhe atyre të larta në moshën 15 vjeçare është 40 pikë në lexim, që është e barabartë me 1.3 vjet shkollim. Ky dallim është shumë më i ulët se sa dallimi mesatar që është vërejtur në mes të këtyre grupeve nëpër vendet e OECD-së (89 pikë).¹

Regjistrimi në arsimin e obligueshëm është shumë i kënaqshëm, megjithatë, sfidë mbetet niveli shumë i ulët i pjesëmarrjes së fëmijëve në nivelin parashkollor, ku **vetëm 6.2%** e fëmijëve të moshës 0-5 vjeç vijojnë edukimin dhe kujdesin në fëmijëri të hershme, një përqindje kjo shumë më e ulët se sa mesatarja e OECD-së (mbi 87%) ose caqet e Arsimit dhe Aftësisimit 2020 (95%).²

6.2%

e fëmijëve të moshës 0-5 vjeç vijojnë edukimin dhe kujdesin në fëmijëri të hershme

¹ "Kosovo Country Note" – Rezultatet e PISA 2018 OECD, 2019. http://www.oecd.org/pisa/publications/PISA2018_CN_KSV.pdf

² Raporti për Kosovën 2020. Komisioni Evropian. Bruksel, 2020. https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/kosovo_report_2020.pdf





NIVELI I ARSIMIT	SHKALLA BRUTO E REGJISTRIMIT (%)
Arsimi parashkollor dhe parafillor (mosha 3 deri 6 vjeç)	38 ³ %
Arsimi parafillor (mosha 5 deri 6 vjeç)	93.1 ⁴ %
Arsimi fillor (klasat 1 deri 5)	100 ⁴ %
Arsimi i mesëm i ulët (klasat 6 deri 9)	90.4 ⁴ %
Arsimi fillor dhe i mesëm i ulët (klasat 1 deri 9)	96 ⁴ %
Arsimi i mesëm i lartë (klasat 10 deri 12)	82.5 ⁴ %



TABELA 1.
SHKALLA BRUTO E REGJISTRIMIT NË TË GJITHA NIVELET E ARSIMIT NË KOSOVË

NIVELI I ARSIMIT	MESHKUJ	FEMRA	GJITHSEJ	% E TË GJITHË NXËNËSVE
Parashkollor/Parafillor	518	395	913	3.5 %
Fillor/I mesëm i ulët	6,495	6,209	12,704	5.5 %
I mesëm i lartë	1,265	1,004	2,269	3 %
Gjithsej	8,278	7,608	15,886	4 %

TABELA 2.⁴
NXËNËSIT ME ASISTENCË SOCIALE

³ Raport Vjetor Statistikor me Tregues Arsimore 2019/20, MASH, Prishtinë, 2020. <https://masht.rks-gov.net/uploads/2020/12/raporti-vjetor-statistikor-me-tregues-arsimore-2019-20.pdf>

⁴ Si më lart.



Grupet më të cenueshme për mospërfshirje në arsim janë fëmijët nga komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian dhe fëmijët me nevoja të veçanta arsimore. Megjithatë, për shkak të mungesës së të dhënave referenciale për popullsinë, është e pamundur të vlerësohet shkalla bruto e regjistrimit të këtyre grupeve në sistemin arsimor.

NIVELI I ARSIMIT	ROM	ASHKALI	EGJIPTIAN	GJITHSEJ
Arsimi parashkollor dhe parafillor (mosha 3 deri 6 vjeç)	9	/	7	16
Arsimi parafillor (mosha 5 deri 6 vjeç)	107	186	60	353
Arsimi fillor dhe i mesëm i ulët (klasat 1 deri 9)	1,085	3,676	1,047	5,808
Arsimi i mesëm i lartë (klasat 10 deri 12)	182	259	137	578
Gjithsej	1,383	4,121	1,251	6,755

TABLE 3.⁵

PJESËMARRJA E KOMUNITETEVE ROM, ASHKALI DHE EGJIPTIAN NË ARSIM

NUMRI I NXËNËSVE ME NVA	GJITHSEJ
Nxënësit me nevoja të veçanta në Qendrat Burimore	349
Nxënësit me nevoja të veçanta në klasa të bashkangjitura	3,903
Gjithsej numri i nxënësve me NVA të regjistruar në arsimin parauniversitar	4,252

TABELA 4.⁵
NUMRI I NXËNËSVE ME NEVOJA TË VEÇANTA Ë ARSIMIN PARAUNIVERSITAR NË KOSOVË

Në anën tjetër, të dhënat për përfshirjen e fëmijëve me nevoja të veçanta në sistemin arsimor lënë për të dëshiruar. Saktësia e të dhënave aktuale të paraqitura në tabelën e mëposhtme është komplekse për shkak të faktit se jo të gjithë nxënësit me nevoja të veçanta që janë regjistruar në klasa të rregullta janë vlerësuar nga ekipet e vlerësimit profesional në komuna.

Equity


⁵ Statistikat e arsimit në Kosovë 2019/2020. Agjencia e Statistikave të Kosovës, qershor 2020. <https://ask.rks-gov.net/en/kosovo-agency-of-statistics/add-news/education-statistics-in-kosovo-20192020>






Krahasuar me vendet e tjera rajonale dhe të BE-së, Kosova vazhdon të shpenzojë më pak në arsim. Niveli i shpenzimeve publike në arsim në vitin 2020 ishte 4.7% si përqindje e BPV (Bruto Produktit Vendor) ose 11.3% e shpenzimeve të përgjithshme të Qeverisë. Përkundër që shuma si përqindje e BPV-së është e krahasueshme me vendet e BE-së, shpenzimet për kokë nxënësi janë jashtëzakonisht të ulëta, gjë që vjen si pasojë e nivelit të ulët të bazës së BPV-së dhe buxhetit të qeverisë, si dhe e numrit mjaft të madh të nxënësve në popullsinë e përgjithshme, krahasuar me vendet e tjera të BE-së.

SHPENZIMET NË ARSIM SI % E SHPENZIMEVE TË PËRGJITHSHME TË QEVERISË



SHPENZIMET NË ARSIM SI % E BPV-SË NË VITIN 2020



Po ashtu, dy kategoritë në të cilat përqendrohen shpenzimet janë kryesisht pagat dhe shtesat dhe shpenzimet kapitale dhe më pak në burime që do të përmirësonin drejtpërdrejt të nxënësve dhe mësimdhënien.

REFORMAT DHE SFIDAT KRYESORE NË SIGURIMIN E MUNDËSIVE TË BARABARTA NË ARSIM

E drejta për arsimim dhe zhvillim të potencialit të plotë të një fëmije është një prej të drejtave themelore dhe si e tillë garantohet me Kushtetutën e Kosovës. Në këtë kontekst, korniza ligjore e Kosovës parashihet dhe mbështet një qasje gjithëpërfshirëse, e cila lufton braktisjen e arsimit të obligueshëm dhe garanton qasje të barabartë në arsim pa marrë parasysh etninë, gjininë, racën, statusin ekonomik etj.

Por, përkundër faktit se masat e tilla janë të rrënjësura në kushtetutë dhe në kornizën ligjore, ekziston një boshllëk i madh në mes të zhvillimit të politikave dhe zbatimit të tyre.

Masat për zvogëlimin e pabarazisë në arsim në nivel vendi

- Arsimi i obligueshëm me qasje të barabartë dhe falas;
- Tekste shkollore falas për të gjithë nxënësit në arsimin e obligueshëm;
- Transporti falas për fëmijët që jetojnë brenda distancës prej katër (4) km nga shkolla;
- Arsimi parashkollor falas për fëmijët nga kategoritë e cënueshme (asistenca sociale, fëmijët me nevoja të veçanta arsimore, fëmijët pa përkujdesje prindërore);
- Themelimi i Qendrave Mësimore për të mbështetur fëmijët që vijnë nga grupet e cënueshme në arsim;
- Krijimi i mekanizmave për të parandaluar braktisjen e shkollës dhe mosregjistrimin në shkollë (EPRBM), dhe në promovimin e diversitetit përmes një sistemi të integruar arsimor;
- Bursa për nxënësit nga komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian që janë të regjistruar në arsimin e mesëm të lartë.



Disa sfida që pengojnë zbatimin e politikave janë si në vijim:

- **Mungesa e llogaridhënies dhe mekanizmeve monitorues** për të siguruar zbatimin e duhur të politikave në nivel nacional, lokal dhe nivel të shkollës;
- **Buxheti i vogël për arsim** dhe alokimi joefikas i burimeve;
- **Mungesa e shërbimeve profesionale (psikologjike dhe pedagogjike)** në nivel të shkollës për të mbështetur aftësinë e nxënësve për të mësuar, për të treguar sukses akademik, social dhe emocional;
- **Mosfunksionimi i organeve drejtuese të shkollës**, respektivisht i këshillit drejtues, këshillit të prindërve dhe nxënësve;
- **Mungesa e programeve për zhvillimin profesional të mësimit në nxënësve** për të pranuar/kuptuar identitetet e nxënësve dhe mënyrat e ndryshme në të cilat ata mësojnë më së miri.

Duke marrë parasysh këto më sipër, **disa rekomandime** me qëllim të përmirësimit të barazisë në arsim, janë listuar më poshtë:

- Rishikimi i Skemës së Asistencës Sociale në Kosovë për të pasur cak varfërinë;
- Rishikimi i Formulës së financimit për Arsimin Para-universitar për të plotësuar nevojat e shkollës;
- Organizimi i orëve plotësuese dhe programeve të tjera këshilluese në nivel të shkollës, për të përmirësuar të nxënësve dhe përfshirjen në shkollë;
- Ofrimi i shërbimeve profesionale në nivel të shkollës, për të adresuar nevojat e veçanta arsimore të nxënësve me status të ulët socio-ekonomik, përmes mbështetjes së vazhdueshme, dhe për të siguruar se ata mund ta përballojnë procesin e të nxënësve;
- Rritja e angazhimit të prindërve në shkollë;
- Ofrimi i programeve për zhvillimin profesional të mësimit në nxënësve (ZHPM) në bazë të nevojave të mësimit në nxënësve;
- Zbatimi i Udhëzimit Administrativ Nr. 19/2018 për themelimin dhe funksionimin e qendrave mësimore;
- Fuqizimi i llogaridhënies, monitorimit dhe vlerësimit dhe qasjeve mbështetëse që synojnë përmirësimin e zbatimit dhe efektivitetit të reformave në sektorin e arsimit.

SHEMBULL I POLITIKËS PREMTUESE: INTERVENIMI I SHKOLLËS – PLANIFIKIMI BUXHETOR I SISTEMIT ARSIMOR PARA-UNIVERSITAR NË BAZË TË NEVOJAVE

Pandemia COVID-19 ka përkeqësuar pabarazinë ekzistuese, duke goditur më së shumti komunitetet më të varfra dhe më të cenueshme. Njësoj, pandemia ka rënduar dallimet para-ekzistuese në arsim midis nxënësve të favorizuar dhe atyre të pafavorizuar duke theksuar kështu rolin e shkollave në ofrimin e mbështetjes dhe zvogëlimin e dallimeve në arritje dhe të nxënësve.

Në mesin e faktorëve të tjerë (p.sh. varfëria, ndarja, diskriminimi), mundësitë jo të barabarta sistematike në arsim vazhdojnë po ashtu me mungesën e financimit si dhe financimin jo të barabartë në shkollë. Në këtë kontekst, formula aktuale e financimit e sistemit arsimor në Kosovë nuk merr parasysh nevojat e veçanta të shkollave.

Duke ditur këto më sipër, **Ministria e Arsimit dhe Shkencës (MASH)** duhet të **rishikojë formulën e financimit për të plotësuar nevojat e shkollave** të cilat do të marrin parasysh në veçanti nevojat më të mëdha financiare për këto shkollë në të cilat vijojnë mësimin komunitet, fëmijët me nevoja të veçanta arsimore, fëmijët me status të ulët socio-ekonomik etj. Qëllimi duhet të jetë përshtatja e buxhetit me situatën infrastrukturale të shkollës, për të ofruar mundësi të barabarta arsimore për fëmijët nga grupet e cenueshme të përmendura më lart. Po ashtu, shpenzimet e ulëta në arsim konsiderohet të jetë pengesë e cila ndikon negativisht në cilësinë e sistemit të arsimit në Kosovë. Prandaj, është shumë e rëndësishme që Qeveria të rrisë investimin për kokë banori në arsim, për të përfshirë shpenzimet e tjera përtej pagave, si: biblioteka, mjediset e jashtme, laboratorët për organizimin e mësimit praktik, kompjuterë dhe organizim të aktiviteteve të tjera jashtë-kurrikulare.

Përveç këtyre, **decentralizimi i mëtejshëm fiskal dhe planifikimi buxhetor i bazuar në nevoja**, do t'ua mundësonin shkollave që të planifikojnë dhe të ndërmarrin masa të ndryshme për të zvogëluar dallimet në arsim. Kjo mund të përfshijë por jo edhe të kufizohet në: organizimin e orëve plotësuese, organizimin e projekteve shkollore, dhe të aktiviteteve të tjera jashtë-kurrikulare, përgatitjen e politikave të shkollave, zhvillimin profesional të mësimit në nxënësve, përfshirjen e prindërve dhe të komunitetit në përgjithësi etj.